

AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR




Autorial nga
Bahri Prebreza

Zbrazjet Atmosferike

faqe 5

Operimet TM1



■ Komerciale ■ Ushtarake ■ VFR

**Për tre muaj u realizuan
rreth 4 mijë operime**

faqe 2



**METEO Feston Ditën
Botërore të Meteorologjisë**

faqe 4



**Menaxhmenti i ASHNA-së u prit në
vizitë në BULATSA të Bullgarisë**

faqe 2



**Delegacioni i ASHNA-së në vizitë pune
në EUROCONTROL dhe Mاستriht**

faqe 3

**ASHNA priti në një vizitë drejtuesit e
ALBCONTROL dhe IGJEUM**

faqe 6

Vizita e delegacionit të ASHNA-së në BULATSA të Bullgarisë




Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), ka zhvilluar takimin e tyre të parë të punës me menaxhmentin e Autoritetin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Bullgarisë (BULATSA) në selinë e kësaj të fundit në Sofje.

Pjesëmarrës në këtë vizitë pune nga Menaxhmenti i ASHNA-së ishin, Drejtori Bahri Nuredini, zv.Drejtori Operativ Ersen Shileku dhe Menaxheri i Zyrës së Drejtorit, Alban Sylaj. Drejtori i ASHNA-së Bahri Nuredini u pritë në takim nga Drejtori

Gjeneral i BULATSA-s Georgi Peev, me ç'rast diskutuan për planet dhe projektet aktuale për zhvillimin e shërbimeve të navigacionit ajror në të dyja vendet. Të pranishëm në takim ishin edhe përfaqësues të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Në këtë takim u ndanë përvojat në lidhje me skemën e performancës dhe projekte specifike ndërkombëtare, të tilla si SESAR dhe Shërbimet e Centralizuar. Palët ranë dakord që takimet të këtilla të intensifikohen në të ardhmen.

Tremujori I -
2016 - 2017



Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, janë realizuar gjithsejtë 3993 operime në total. Këtë

shifër të operimeve nëse e krahasojmë me numrin e operimeve të realizuara gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, del se kemi një rënie të lehtë të

Për tre muaj u realizuan rreth 4 mijë operime në ASHNA

operimeve me një ndryshim prej -9%. Ndërkaq nga totali i operimeve prej 3993, Komerciale kanë qenë 2880 Operime, ku në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak vërehet një ndryshim prej -4%, pastaj operime ushtarake kanë qenë

gjithsej 291 apo rreth -6% më pak se në periudhën e vitit 2016, si dhe operimet tjera apo VFR, përbëjnë shifrën e 822 operimeve, ku në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, vërehet një ndryshim për rreth -25% operime më pakë.



Delegacioni i ASHNA për vizitë pune në Eurocontrol dhe Maastricht

Një delegacion i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), i prirë nga drejtori Bahri Nuredini, është pritë në një vizitë pune në Organizatën e Aviacionit Civil në Evropë - EUROCONTROL me seli në Bruksel si dhe në Qendrën e Kontrollit të Hapësirës së Lartë Ajrore (MUAC) në Maastricht - Holandë

Takimi është zhvilluar me datë 16 dhe 17 mars, me ç'rast delegacioni nga ASHNA është pritë nga krerët më të lartë të EUROCONTROL dhe MUAC, ku u diskutua për fushat e bashkëpunimit midis këtyre organizatave dhe ASHNA-së.

Takimi në Bruksel ishte i pari ndërmyjet përfaqësuesve nga Kosova dhe homologëve nga EUROCONTROL në selinë e këtyre të fundit. Përfaqësuesit e ASHNA-së cekën dhe elaboruan

çështjet me të cilat përballet ASHNA në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror. U theksua fakti, që Kosova si nënshkruese e Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), është duke zbatuar gjithë rregullativin e aplikueshëm në Evropë sa i përket aviacionit civil, për më tepër, Kosova konsiderohet si një ndër vendet që prin në këtë drejtim. Me gjithë faktin që Kosova ka përparuar mjaft në drejtim të zbatimit të kërkesave që dalin nga këto direktiva dhe rregullore, përfaqësuesit e ASHNA-së i shprehën shqetësimin homologëve nga EUROCONTROL për vështirësitë e shumta që ASHNA i hasë në ushtrimin e aktiviteteve të saj.

Përfaqësuesve të EUROCONTROL iu kërkua që Kosova të jetë

pjesë e forumeve teknike të EUROCONTROL-it, po ashtu Publikimi dhe Informacioni Aeronautik i Kosovës (AIP), të publikohet përmes EUROCONTROL, që të mundësohet pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga Instituti për Shërbime të Navigacionit Ajror (IANS) në Luksemburg pa pagesë për personelin nga Kosova si dhe të trajtohet mundësia e anëtarësimit të Kosovës në EUROCONTROL.

Ndërkaq sa i përket anëtarësimit të Kosovës në EUROCONTROL, përfaqësuesit e kësaj të fundit shpjeguan arsyen pse sipas tyre Kosova nuk mund të bëhet anëtare në këtë moment. Sipas tyre, përveç kundërshtimit nga ana e Serbisë, një i tillë është edhe nga Spanja, e ku dihet mirëfilli që anëtarësimi në EUROCONTROL bëhet me votim njëzëri të të

gjithë anëtarëve të saj. Përveç kësaj, paraprakisht kërkohet që Kosova të anëtarësohet në Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC), dhe më pastaj të aplikojë në mënyrë zyrtare për EUROCONTROL, duke qenë se mungesa e anëtarësimit në ECAC ia ka pamundësuar edhe Izraelit mundësinë për t'u anëtarësuar në EUROCONTROL. Përfaqësuesit nga EUROCONTROL, u zotuan që do të luajnë rolin konstruktiv në normalizimin e hapësirës së ulët ajrore duke qenë se situata e tanishme nuk është në interes të sigurisë dhe mjedisit.

Po ashtu delegacioni nga Kosova ishte për vizitë në Qendrën e Kontrollit të Hapësirës së Lartë Ajrore në Maastricht (MUAC), nga e cila kontrollohet hapësira e lartë ajrore e Holandës, Belgjikës, Luksemburgut dhe një pjesë e Gjermanisë. Në këtë takim pati shkëmbim të të dhënave me bashkëbiseduesit, si dhe u cekën fushat në të cilat mund të bashkëpunojmë në të ardhmen. Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni nga ASHNA pati mundësi të shohë nga afër sistemin e avancuar të kontrollit të trafikut ajror që përdoret në Maastricht.

Gjatë kësaj vizite, delegacioni nga ASHNA arriti dakordimin që të vijohet më tej bashkëbisedimi për çështjet teknike.



METEO Feston Ditën Botërore të Meteorologjisë

Departamenti Meteorologjik i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) për herë të 17-të festoi Ditën Botërore të Meteorologjisë, bashkarisht me Institutin Hidrometeorologjik të Republikës së Kosovës. Zakonisht në këtë datë pos karakterit festiv, autoritetet e shumta meteorologjike (nëse festojnë së bashku), duke përmbledhur rezultatet, qesin në dritë edhe dobësitë të cilat në shumë raste indirekt kanë shtuar edhe inicimin dhe bashkëpunimin pikërisht për ato pika të dobëta. Departamenti Meteorologjik i ASHNA-së, duke pasur ne rend të parë efience kualitative, ne shume raste ka qenë edhe inicuese e ideve te përbashkëta, si ne meteorologjinë operative në shërbim të aviacionit ashtu edhe ne aplikacionet tjera në shërbime ndër sektoriale të shoqërisë. Këtë vit Organizata Botërore e Meteorologjisë (WMO) pos miratimit të një plani të ri strategjik, buxhetit, zgjedhi edhe Sekretarin e ri. Ky plan strategjik përcakton prioritetet për

post agjendën globale 2015, për vitet 2016-2019. Disa nga këto veprime të këtij plani mbështeten në dokumentet e reja dhe më voluminoze të përditësuara në dy vitet e fundit, në Marrëveshjen e Parisit dhe në dokumentin e Panelit të Klimës të OKB-së, IPCC AR5. Disa nga pikat e këtyre dokumenteve, ende mbesin pa ndonjë ndryshim të madh, si pikat në vijim: (1) reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë si rezultat i motit dhe klimës; (2) shërbimet e klimës për të ndihmuar përshtatjen nga ndikimet e Ndryshimeve Klimatike dhe për të ndihmuar përshtatjen për Zhvillimin e Qëndrueshëm; (3) forcimi i sistemit te observimit dhe respektimi i sistemit te informacionit të motit dhe klimës, (4) nga fakti se ndikimi i lartë i motit ekstrem si rezultat i Ndryshimeve Klimatike ka mundësi të ndodhë me frekuencë më të madhe dhe intensitet më të madh, etj. E se sa të rëndësishme janë Shërbimet Meteorologjike Kombëtare dhe shërbimet hidrologjike,

këtë më së miri e ka potencuar Michel Jarraud, ish Sekretar Gjeneral i WMO-së, "Rritja e temperaturave, ndryshimet ne ciklin hidrologjik, sasia rekorde e gazeve serë dhe ngrohja globale bashkë me aciditetin e oqeanëve, do të kenë ndikim të madh në shoqëri. Ne ende kemi një dritare të mundësisë për të vepruar dhe për të parandaluar dëmet e pakthyeshme, por ajo është duke u mbyllur shpejt. Kërkesat për shërbimet Meteorologjike Kombëtare dhe shërbimet hidrologjike, kurrë nuk kanë qenë më të larta. Investimet në këto shërbime, do të çojnë në përfitime të mëdha socio-ekonomike WMO rikujtoi se humbjet nga polisat e sigurimit nga katastrofat natyrore, shkonin në mes 10 deri në 50 miliardë dollar për çdo vit gjatë dekadës së kaluar. Ndërmjet 1970-2012, rreth 2 milion njerëz kanë vdekur nga rreziqet hidrometeorologjike edhe pse numri i të vdekurve tregon një tendencë në rënie, për shkak të paralajmërimeve të hershme të katastrofave. Pos motit dhe klimës konvencionale edhe rreziqet mjedisore, si Moti Hapësinor, hiri vullkanik dhe rëra e pluhuri nga stuhitë e pluhurit, gjithashtu kanë potencial të konsiderueshëm për të shkaktuar humbje ekonomike (për shkak të çrregullimit të komunikimit dhe transportit). Edhe vendet ne zhvillim dhe tranzicion kanë benifitet nga agjendat e WMO-së. Se fundi, në

projektin që do ta përfshijë Ballkanin, edhe Kosova do ta ketë mundësinë që te jete pjese e këtij projekti. Pra, bëhet fjalë për integrimin në Projektin e Konsorciumit të Evropës Juglindore për Parashikimin e Motit (SEECOP), i themeluar në mars 2015. Këto benefite ne shkalle regjionale do ta nxjerrnin Kosovën nga pozita e saj pothuaj inferiore. Objektivi kryesor i SEECOP është t'iu ofrojë shteteve anëtare, sistemin NËP bazuar në Multiscale Model i zhvilluar nga NCEP amerikan, si për research, zhvillim dhe për përdorim operacional në parashikime meteorologjike dhe hidrologjike, aplikime atmosferike dhe shërbimet përkatëse paralajmëruese. Kosova dhe Shqipëria janë në fazën e miratimit të ligjeve për veprimtaritë hidrometeorologjike. Ne këtë proces idetë nga ASHNA kane qene te mirëpritura. Falë këtij ligji, Kosova do të ketë mundësi të përfaqësohet në Organizatën Botërore të Meteorologjisë në nivel të përshtatshëm përkundër statusit të saj në UN. Manifestimi i 23 marsit, shënohet edhe me edicionin e ri dhe të shumëpritur "ATLASI I REVE", i përmirësuar nga përvojat e reja disa dekadëshe. "ATLASI I REVE" është një publikim udhëzues referimi dhe autoritativ me klasifikime të detajuara të reve, me përshkrime të reja te reve dhe të fenomeneve të motit!



Bahri Prebreza

Mbikëqyrës i Divizionit të Parashikuesve

Zbrazjet atmosferike kanë qenë prezente në tokë shumë kohë para se jeta të zhvillohej në planetin tonë. Studimi i parë në lidhje me zbrazjet atmosferike që mund të cilësohet shkencor, është bërë në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII nga Benjamin Franklin.

Në muajin shkurt 2017 doli nga botimi libri "Zbrazjet atmosferike", botim i veçantë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, me autorë Akademik Prof.Dr. Isuf F. Krasniqi dhe Dr.sc. Bahri M. Prebreza.

Libri "Zbrazjet atmosferike" është një studim në lidhje me modelimin dhe analizën e ndikimit të zbrazjeve atmosferike në sistemet elektroenergjetike. Ky libër merret edhe me sistemin mbrojtës të sistemit elektroenergjetik nga mbitensionet atmosferike.

Analiza e ndikimit të këtyre mbitensioneve dhe ndërmarrja e masave efikase mbrojtëse e rrit efektivitetin e funksionimit të procesit të transmisionit të energjisë elektrike dhe zvogëlon koston e tërësishtme të implementimit

Zbrazjet atmosferike

dhe mirëmbajtjes së sistemit të transmisionit të energjisë elektrike. Sistemi elektroenergjetik dhe operimi i tij i rregullt është me një rëndësi të jashtëzakonshme për çdo vend. Ndërprerjet e energjisë elektrike afektojnë aktivitetet njerëzore si dhe performancën ekonomike të vendit.

Rekomandimet për mbrojtjen e sistemit në terma të koordinimit të izolimit dhe shkarkuesve të mbitensionit janë



Zbrazjet atmosferike re-re, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

dhënë në libër, duke kryer simulimet dinamike përkatëse përmes softwer-it MATLAB, kurse për analizën e mbitensioneve atmosferike dhe ndikimin e tyre në sistemin elektroenergjetik është përdorë softweri ATP-EMTP (Alternative Transients Program - Electro-Magnetic Transients Program).

Frekuenca dhe lokacioni i zbrazjeve atmosferike në Kosovë është siguruar nga sistemi automatik i lokalizimit të zbrazjeve atmosferike SCALAR i vendosur në KOSTT (Kosovo Transmission System and Market Operator) si dhe nga të dhënat

Departamenti Meteorologjik në ASHNA. Këto të dhëna janë shfrytëzuar për të bërë krahasimet me ndërprerjet e regjistruara nga KOSTT-i gjatë një periudhe të caktuar kohore.

Parametrat që kanë rëndësi për llogaritjen e performancës së sistemit elektroenergjetik si dhe për llogaritjet me metoda të ndryshme mbrojtëse janë: amplitudat e rrymave goditëse dhe dendësia e zbrazjeve


ky fenomen mund të paraqitet.

Sipas statistikave, një nga shkaktarët kryesorë të ndërprerjeve në sistemet elektroenergjetike janë mbitensionet atmosferike, në shkallë prej përafërsisht 30-40%.

Në libër është dhënë niveli keraunik për territorin e Kosovës, i cili definon numrin e ditëve në vit në të cilat goditja e rrufesë është dëgjuar dhe nga këto të dhëna është formuar harta e nivelit izokeraunik të Kosovës.

Mirëpo, edhe pse frekuenca e dështimeve në linjat e transmisionit, që ka rezultuar me ndërprerje të energjisë elektrike në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës ka rënë vit pas viti, paraqitja e vështirësive nga zbrazjet atmosferike, nuk ka shënuar rënje.

Libri "Zbrazjet atmosferike" jep një kontribut në modelimin, analizën empirike, realizimin dhe përpunimin e matjeve, regjistrimeve dhe vrojttimeve në lidhje me paraqitjet e zbrazjeve atmosferike dhe ndikimin e tyre në sistemin elektroenergjetik, me theks të veçantë në linjat e transmisionit të tensionit të lartë.



Zbrazjet atmosferike re-tokë, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

ASHNA priti në vizitë drejtuesit e ALBCONTROL dhe IGJEUM



Më datë 10 Shkurt, jemi vizituar nga Drejtori i IGJEUM (Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit të Shqipërisë) - Z. Fatos Hoxhaj, që njëherit është edhe përfaqësues permanent i Republikës së Shqipërisë në OBM (Organizata Botërore e Meteorologjisë) dhe nga Prof. Petrit Zorba-përgjegjës i departamentit të mjedisit dhe

klimës pranë IGJEUM. Mysafirët nga Tirana janë pritur nga Drejtori si dhe Zv. Drejtori për Shërbime Operative të ASHNA. Poashtu ata janë shoqëruar nga ana e Menaxherit të Departamentit Meteorologjik - Z. Sherif Gosalci edhe gjatë vizitës në IHMK si dhe në Ministrinë e MPH-së, ku janë takuar me drejtoreshën e IHMK-së Znj. Letafete Latifi dhe

Zv. Ministrin e MMPH-së Z. Mendim Rugova. Nga takimet është vlerësuar e domosdoshme vënia e komunikimit me OBM dhe drejtuesit e saj dhe roli e asistimi i IGJEUM në këtë drejtim.

Nga IGJEUM, disa ditë nga vizita, kemi pranuar ofertën që një kolegë i yni të marrë pjesë për rreth tre muaj në trajnimin e organizuar nga EUMETSAT në Darmstadt të Gjermanisë për specializimin në imazhet satelitore meteorologjike, trajnim ky i mbuluar me shpenzime nga EUMETSAT. ASHNA ka dhënë propozimin, dhe ka dërguar detajet e personit të propozuar dhe është në pritje të përgjegjës nga IGJEUM, me qëllim të realizimit të këtij trajnimi të rëndësishëm.

Më 13 Shkurt, kemi pasur një vizitë të paralajmëruar që në muajin Janar nga ana e Menaxherit të Sektorit të Meteorologjisë nga Albcontrol - Agjencia e Navigimit Ajror nga Shqipëria. Me Z. Arben Sancolli, kemi shkëmbyer informata të shumta dhe përvoja të ndërsjella me qëllim të arritjes dhe plotësimit të standardeve të kërkuara në fushën e meteorologjisë aeronautike. Me kërkesë të Z. Sancolli dhe me aprovim të menaxhmentit, jemi pajtuar që Sektorit të Meteorologjisë - Albcontrol të i huazojmë paisjen për matjen e shtypjes atmosferike, PAB (Precision Aneroid Barometer) për qëllime mbylljeje të gjetjeve nga EASA. Pajisja ka qëndruar në Albcontrol në periudhën 06-13 Mars.

IMPRESSUM

Redaktor: Driton Ujkani

Kontribuan: Alban Sylaj, Sabit Gashi, Sherif Gosalci dhe Bahri Prebreza

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Vrellë, Lypjan, 10070,
Republika e Kosovës
Tel: +381 (0) 38 59 58 641
E-mail: info.ashna@rks-gov.net
Web: www.anp-ka.org

